

LISANDRI & ARISTEA KOLA

TARALLOQJA E VATANIT

Më datën 5 korrik n'për terr
Krejt Shqipnisë i bini 'i sherr,
Mbas tre muejsh që ra kolera,
Nji hall tjetër i ra te dera;
Tanë Shqipnia la shndetsinë
E kthei sytë mbi letërsinë.
Kah njeni me alltipatllare
Që e kish mbiemnin Tare,
Mbasi pat kënë me kacabûj
Dy shkrimtarë i quejti spiûj:
Njatë Koliqin vetullvramë
E njatë Camajn n'shêj i damë.

Siç po thonë gojët e liga
Që gjithkah gjejnë veriga:
Nji ish-kapterr komunist
Që ma vonë duel basketbollist.
Mandej 'hyni 'i farë bërlllogut
Tue marrë zejen e arkeollogut,
Kesh po ditka për ujna e dete
Edhe njerëzve me u kja derte.
Nji kryekuq, skërfyell i gjatë
Tash ka marrë tjetër zanat.
Nji natë t'bukur e kapi 'i dell
Tha: 'Unë jam studiues me zell!
E la anash ai lopatën
E s'vonoj e mprehi shpatën
(Edhe 'i herë për situatën).
Thamë ksi rodi i pat hupë fara
Për me u marrë me 'punë të mbara'.
Auron Tare nji rrymlyk
Ç'na bani me hangër byk—

Me tridhetë e kusur faqe
Që i shkroi porsi rrangaqe.
'Kam dhetë vjet, thotë lum zotnia,
Që kërkoj unë nëpër CIA:
E jam ba porsi bukë fike
Tue hapë dosjet britanike,
Kur kto t'dyja i vuna n'fé
Atëherë ktheva në atdhé.'
E kështu pra, Tare trimi
Msyu rrugën kah Sigurimi.
E këtë e bani si mos pvet
Se e pat mësue i ati 'vet.
Që me u dukë sensacional
Edhe n'daçi 'okcidental',
Ai s'kish kënë njifarë kopukut
Që kët barrë m'ia lanë facebook-ut;
E mendoj që me marrë famë,
Tha: 'po gjej 'j botues me namë'.
E mejherë në mendje i mbiu,

Tha: 'po e çoj te Ardian Vehbiu'.
Me dorë të *majtë* ia dorëzoi
E ma tepër ai nuk mendoi.
Ky Vehbiu 'i zemërgjanë
Tha: 'nji vend duhet m'ia dhanë;
Që me dalë profesionale
Baj 'hymje redaksionale,
Që na punën me e pasë gati:
Me i la duert si Ponc Pilati.'
Çiftit Kola ky artikull
I erdh n' darkë si me kënë ndrikull.
E s'vonuen me dalë në shteg
Po u banë gati për bejleg.
Ndëjë tanë natën n'laptop gërmuq:
Tue lexue sytë iu banë duq.
Tue e këndue me shumë merak
Që Auronit mos me i hy n'hak,
I cili i pat hy 'ifarë teme
Me 'i titull 'Mitët e rreme'.

Tue pá këtë sahan me pshesh,
Mjekra Lisit iu çaravesh
Prej këtij studiuës ‘rangut’
Me do fakte false o mangut.
Kshtu dyshja reagoi s’pari,
Edhe këtu pra u hap sipari.
Ndokush nisi me u ba busull,
Edhe muer e shkroi një pusull,
E la të shkrueme në defter:
Ia la Akademisë këtë nder.
Primo Shllaku picroi synin
Edhe gojës ia vûni drynin!
Po shtrëngue prej këtij zori,
Ndoshta flet ai kah shtatori.
Filloi puna t’u tjerrë n’pê
Sepse sherri, thonë, don ngê.
E t’u lidhën varg si speca
Mbas komentit që la Ndreca.
Nisi mielli tue u blue trashë

Tue hekë gacat hiç pa mashë.
Qit-e-prit u ndanë në lagje
Për m'e ba bukën në magje.
Tue pasë parasysh kêt 'delikt'
Akademia dha 'verdikt'.
Këtë degame e nxuer dere,
E flutroi bash prej penxhere.
Për m'u xanë çështja ma besë
Përdor fjalt' e Kadaresë.
Për Camajn diç formuluen
Se Koliqin krejt harruen.
Njado intelektualë
Për me kënë ma aktualë
E me iu dukë bukur loja
Rreken me shkrue si Shantoja,
Porse kryet kanë bosh si krap—
Shkojnë si cjapi te kasapi,
Veç me sha, e vrâ e kthjellë
E as tekstin lexue thellë:

Do ksish pra janë profesora,
Po p'r *figj*ut u ka dekë ora.
Profesora veç në letër
Sepse mendja u asht ba lepër.
Veçse rëja ma zymtane
Ka xanë vend në pellg Tirane,
Kshtu pra tjerë studiues në za
Për këtë punë ala s'kanë bza;
Edhe pse titujt shkencorë
Me Koliqin i fut'n n'dorë,
A me Camajn ba karriera
Ndërsa tash na vëjnë barriera
Me ksi punësh, thonë, s'përzihen
Se shkenctarë të 'mdhaj' po ndihen (?).
Fort si shumë pra ndër katedra
Kanë mbî keq barishte t'egra,
Që rreshtojnë tituj çdo vjetë
Pa pasë shkruë kurrë libër vetë.
Për atë punë që bani Tare,

U trand krejt toka shqiptare.
Tue çue erë n'për stome e fusha
Kah po rendnin ndër gajusha,
Tue i dhanë krahve e gojës
Thue se janë n'Luftën e Trojës:
Rrah pra ujin në havan
Kryet babune qit n'ekran,
Përsrit veten Tare i shkretë
Porsi peshku n'zall ai mbetë.
Kêt debat veç boll e ndihu
Prej Kosove, Genc Salihu.
Si Diomedi idhtë kundrue
Porsi anza tue t'pickue.
Erald Kapri për nga fakti
Der tash po del ma i sakti:
Deh pra Tare edhe fort huqi
Me 'i gjegje nga Gurakuqi.
Po ma heret e dermishi
Me shkrime t'veta K. Dervishi.

Nga katedra q'la Martini
Nji përgjigje e bukur mbrrîni.
Demiraj foli bash kokërr,
Tue sqarue me ngê çdo dokërr.
Analistët pro e kundër
Mendimet i vûnë në lundër.
Tash Tares po i del dallash
Mat nji pllambë e shkep nji pash:
Pse ia dhe kêt zavall kresë
Ti tue hy në pyll pa kmesë?
Për me e qitë punën në treg
Me kalë t'cofun s'dêlet n'breg.
E do tjerë morën yrysh
Tue t'i ba kalit tand 'ysh',
E s'po dimë ku po t'mbetë pahi
Mbasi t'cofi-e thafti krahi.
Me t'u përqethë tanë shtati,
Kah po flet Andi Bushati,
Aq shumë trupin çon puçrriza:

Si me kënë tue t'hangër miza.
Pa i hukatë kalit tand
Nuk po rrinë deh anekand.
Po i jep si analistë:
N'fund dalin kontrabandistë.
Siç thonë gazetat shqiptare,
Kët mjeshtri p'e njohka Tare.
E kur puna vojti ma keq
Duel shkrimi 'Bashkë apo veç?'.
Ky qëndrim i editorit,
Ba me hangër thojtë prej zorit,
Ndoshta asht lëvizje taktike
A ma mirë demagogjike.
Ky debat gjithëkombtar
S'ka pse t'jetë 'partikular',
E kshtu pra as 'fanatizëm'
Aq ma tepër 'krahinizëm'.
N'këtë debat toskë e gegë
Janë ba bashkë 'si kokrrat n'shegë'.

Pra ky asht bash shqiptarizëm,
Jo siç thoni 'folklorizëm'.
Edhe thuej atij tebdilit
Se janë pilastrat e ekzilit.
Nuk e dimë si editor
Për Taren falsifikator
Ç'pozicion keni me marrë
Se asht e bukur do barrë!?
Për fakte n'dosje po flasim
Se ma tej nuk po iu ngasim.
Mandej fryne porsi veri
Dhe do 'shokë' që la Enveri,
E ngjyen pendën trashë një gisht
Pa i ba ata 'punës' bisht.
Njado burra ndëjë kah SHQUPI
Si me thanë njaj Frrok Çupi;
Shoku tjetër që u ndie n'faj
Ishte edhe Besnik Mustafaj,
Demokrat katërqind okësh:

Nuk ndahet ai prej shokësh.
Këto kriptokomunista
—Sikur s’qenë socrealista (!?)—
Që der dje levduen regjimin
Mbrojnë Koliqin e Martinin.
Le ta dijë krejt mileti
Se ata kanë folë për veti,
As për temë, as për opinion
Si gjithherë e kanë zakon.
S’po asht ngêja me përmendë
Shumë do tjerë që u turrën n’pendë,
As do tjerë që i mori vala
Tue u majë, po, porsi njala.
Tarja e tjerë që luejnë zaresh
E që hynë në kësisoj vallesh,
Ta dinë se Camaj-Koliqi
Janë si ferra n’shpinë iriqi,
E jo t’butë si lepurusha
Që janë t’mirë me ba pellusha.

Le t'jetë debat konstruktiv
Me fakt dokumentativ,
Pa shartue, pa coptue tekstin
Mundsisht pa ndryshue kontekstin!

Michigan
20 Korrik 2020